



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202001696/10

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandim për përmirësimin e procedurës që ka të bëjë me njohjen e të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohën (afatin) kur duhet të zbatohet ajo (rasti i të dënuarit K. M.)*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Drejtorit të Përgjithshëm

Z. Agim Ismaili

**Tiranë**

**IEVP MALËSI E MADHE**

Drejtorit

Z. Maliq Meta

*Të nderuar zotërinj,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit në vitin 2020 ka paraqitur ankesë i dënuari K. M., i cili gjatë kësaj kohe ishte duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Malësi e Madhe.<sup>1</sup> Ndër të tjera, ai ka ngritur shqetësimin se njoftimi për dhënien e një mase disiplinore për prodhim të rakisë i është njoftuar dy muaj e gjysëm pas marrjes së këtij vendimi. Sipas tij, jo vetëm që nuk e kishte kryer shkeljen, por marrja

<sup>1</sup> Me shkresën me Nr. 745/2 prot., datë 19.05.2021 të IEVP Malësi e Madhe jemi informuar se shtetasi K. M. është liruar me shkak ligjor "plotësim kohe", më datë 18.05.2021, pasi ka vuajtur dënimin.

dijeni me vonesë për këtë masë disiplinore e bënte të pamundur kundërshtimin e saj duke qenë se kishte kaluar afati i ankimit.

Për verifikimin e kësaj ankese kemi patur në vijimësi letërkëmbim me IEVP Malësi e Madhe, ku fillimisht kemi kërkuar<sup>2</sup> të na vihet në dispozicion dokumentacioni i praktikës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore ndaj të dënuarit K. M. dhe më pas kemi kërkuar<sup>3</sup> të infomohemi nëse në përmbyllje të kësaj procedure, pas marrjes së vendimit a i kërkohet të dënuarit/paraburgosurit të nënshkruajë se ai ka marrë dijeni për masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe si veprohet nëse ai nuk pranon të nënshkruajë.

Referuar dokumentacionit që na është dërguar nga IEVP Malësi e Madhe<sup>4</sup> rezulton se, në muajin Janar 2020 është raportuar se gjatë kontrollit në datën 14.01.2020 në dhomën e të dënuarit K. M. është gjetur një qese me bërsi për të prodhuar pije alkoolike dhe me Urdhrin Nr.168, datë 14.01.2020 ka nisur procedura disiplinore ndaj këtij të dënuari. I dënuari ka dhënë shpjegime para Këshillit Disiplinor ku në procesverbalin e mbajtur për seancën dëgjimore është shënuar se ai ka deklaruar se ka dijeni për arsyen e thirrjes dhe se ato që janë gjetur në dhomën e tij nuk janë bërsi, por mbeturina të hedhura në tas me kos, të cilat më pas kanë marrë erë. Nga praktika shkresore që na është vënë në dispozicion, evidentojmë se procesverbali është i nënshkruar vetëm nga anëtarët e Këshillit Disiplinor. Në përfundim të procesit, Këshilli Disiplinor bazuar në nenin 116, pika 3, shkronja d, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve miratuar me VKM Nr.437, datë 20.05.2015, në të cilën parashikohet se mbajtja e sendeve të ndaluara konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Mbajtje në mjedise të veçanta për 10 ditë”<sup>5</sup>, duke filluar nga data 29.01.2020. Sipas qëndrimit të mbajtur nga IEVP Malësi e Madhe, bërsitë janë send i ndaluar pasi shërbejnë si lëndë për të prodhuar pije alkoolike, por në vendimin për dhënien e masës disiplinore nuk citohet akti nënligjor ku përcaktohen

---

<sup>2</sup> I jemi drejtuar me kërkesë dhe kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion me shkresat: Nr.K2/K2-2 Prot., datë 17.02.2020; K2/K2-4 Prot., datë 09.06.2020; K2/K2-2 Prot., datë 03.11.2020; K2/K2-3 Prot., datë 22.12.2020; K2/K2-5 Prot., datë 18.01.2021 dhe K2/K2-4 Prot., datë 25.02.2021.

<sup>3</sup> K2/K2-6 Prot., datë 11.03.2021 dhe K2/K2-7 Prot., datë 16.04.2021.

<sup>4</sup> Shkresa Nr.270/1 prot., datë 29.01.2021.

<sup>5</sup> Në nenin 118 “Masat disiplinore” të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet si vijon:

.....

2. Për shkeljet disiplinore të rënda zbatohen këto masa:

a) përrjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

b) mbajtja në mjedise të veçanta;

c) përrjashtim nga ajrosja në grup, por jo më shumë se 20 ditë.

sendet e ndaluara. Në përfundim të procedurës disiplinore, I EVP-ja ka protokolluar dokumentin Nr.168/3, datë 14.01.2020 “*Masë disiplinore për të burgosurin K. M.*”, që mban nënshkrimin e drejtorit. Në këtë dokument citohet vendimi i marrë ndaj të dënuarit, baza ligjore dhe e drejta për t’u ankuar brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pranë Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ky dokument, i përpiluar për të njoftuar të burgosurin K. M. me vendimin e marrë ndaj tij, nuk është shoqëruar me një kopje të vendimit dhe të procesverbalit të seancës dëgjimore.

Pyetjes së parashtruar nga ana jonë drejtuar I EVP Malësi e Madhe nëse i kërkohet të dënuarit/paraburgosurit të nënshkruajë, se ai ka marrë dijeni për masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe si vepohet nëse ai nuk pranon të nënshkruajë, nuk i është dhënë përgjigje nga ky institucion. Pretendimi i ngritur nga i dënuari K. M. nuk është prapësuar me shpjegime apo dokumentacion provues nga I EVP-ja, gjë që na lë mundësi të besojmë se ankesa e tij është objektive dhe e arsyeshme.

Në këto rrethana, vlerësojmë se ka vend për përmirësimin e procedurës që duhet të ndiqet nga administrata e burgjeve lidhur me njohjen e të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohën (afatin) e zbatimit të saj.

Procedura e dhënies së masave disiplinore ndaj të burgosurve është e parashikuar në nenin 54/1 të Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar,<sup>6</sup> (i shfuqizuar aktualisht nga Ligji Nr.81/2020) si dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

---

<sup>6</sup> Ligji i cili ka qenë në fuqi, në kohën e dhënies së masës disiplinore shtetasit K. M. Në nenin 54/1 të tij parashikohet si vijon:

*Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore, pasi ka dëgjuar më parë personin ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, nëse ai dëshiron të shprehet.*

*Njoftimi i personit të interesuar ose refuzimi i tij për t’u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe, në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga stafi, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.*

*I dënuari dhe i paraburgosuri mund të mbrohet vetë ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme, u garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tyre ose për të kundërshtuar provat ndaj tyre u garantohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen e tyre.*

*I dënuari dhe i paraburgosuri kanë të drejtë të kenë përkthyes, nëse nuk mund të kuptojnë ose flasin gjuhën shqipe.*

*Organet kompetente i dorëzojnë të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masave disiplinore.*

Referuar nenit 120, pika 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, njoftimi i të paraburgosurit apo të dënuarit, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.<sup>7</sup>

Ndërsa, pika 5 e nenit 120 parashikon se, komisioni disiplinor i dorëzon të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore, pa përcaktuar nëse duhet të nënshkruhet ose jo nga i interesuari.

Pavarësisht se në legjislacionin në fuqi nuk parashikohet shprehimisht se i burgosuri duhet të nënshkruajë vendimin që i komunikohet dhe në rast refuzimi, vendimi duhet të nënshkruhet nga dy persona të tjerë të personelit me shënimin “refuzon firmën”, çmojmë se kjo procedurë duhet të zbatohet në të gjitha I EVP-të për të mos lënë mundësi që të ngrihen pretendime, qoftë edhe të pabazuara. Nga ana tjetër sjellim në vëmendje faktin se barra e provës për respektimin e procedurës bie mbi institucionin që e ka ndërmarrë atë. Nëpërmjet njohjes me vendimin e marrë, të burgosurit i krijohet mundësia për t'a ankimuar masën disiplinore duke iu garantuar në këtë mënyrë e drejta për një proces të rregullt ligjor.

---

<sup>7</sup> Në Nenin 120 “Procedura e dhënies së masave disiplinore” të Rregullores, përcaktohet:

1. Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore pasi ka dëgjuar të paraburgosurin apo të dënuarin, nëse ai dëshiron të shprehet, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore.

2. Njoftimi i të paraburgosurit apo të dënuarit, ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.

3. I dënuari apo i paraburgosurimund të mbrohet vetë ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme. Gjithashtu, atij i garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tyre ose për të kundërshtuar provat ndaj tyre, si dhe garantohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen.

4. I dënuari apo i paraburgosuri gëzojnë të drejtën të kenë përkthyes, nëse nuk mund të kuptojnë ose flasin gjuhën shqipe.

5. Komisioni disiplinor i dorëzon të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masës disiplinore.

6. Masa disiplinore nuk mund të jepet nëse kanë kaluar 30 ditë nga konstatimi i saj.

Vendimi për dhënien e masës disiplinore është akti përfundimtar i përmbylljes së procedurës disiplinore dhe duhet të përmbajë të dhënat e përcaktuara në nenin 99 të Kodit të Procedurës Administrative, ndër to edhe bazën ligjore.<sup>8</sup> Në vendimin e marrë për të dënuarin K. M. nuk është cituar akti nënligjor ku përcaktohet se bërsitë janë send i ndaluar.

Dokumenti Nr.168/3, datë 14.01.2020 “*Masë disiplinore për të burgosurin K. M.*”, i përpiluar për të njohur të dënuarin me masën disiplinore duhet të kishte bashkëlidhur vendimin e nënshkruar nga anëtarët e Këshillit Disiplinor, në zbatim të nenit 54/1 të Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, i ndryshuar dhe neneve 119/8 – 120/5 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, sipas të cilave të burgosurit i dorëzohet një kopje e arsyetuar e vendimit. Gjithashtu të burgosurit duhet t’i vihet në dispozicion edhe një kopje e procesverbalit të seancës dëgjimore, pasi edhe deklaratimet e pasqyruara në këtë procesverbal mund të jenë objekt i kundërshtimit.

Një çështje e rëndësishme ku dëshirojmë të ndalemi dhe të sillet në vëmendjen tuaj edhe për të ardhmen, gjatë zbatimit të procedurës së dhënies së masave disiplinore nga organi kompetent është edhe koha (afati) i zbatimit të masës disiplinore.

Referuar nenit 67, pika 4 e Ligjit Nr.81/2020<sup>9</sup>, masa disiplinore fillon efektin e saj nga momenti i marrjes së një vendimi nga komisioni disiplinor. Ndërsa masat disiplinore, të parashikuara në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 1 të nenit 64 të këtij ligji (përfshirë nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 dhe 14 ditë), i fillojnë efektet nga momenti i zbatimit.

---

<sup>8</sup> Në nenin 99 të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet:

.....

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

iv) bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese;

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;

iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

<sup>9</sup> Ligji, i cili ka hyrë në fuqi që në gusht të vitit 2020 dhe gjen zbatim aktualisht në dhënien e masave disiplinore ndaj të burgosurve.

Çmujmë se zbatimi i masës disiplinore “*përrjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta*”, duhet të zbatohet pasi të ketë kaluar afatit ligjor brenda të cilit i burgosuri ka të drejtë të ankimojë vendimin ose kur Komisioni i Apelit ta ketë lënë në fuqi atë, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me shkelje shumë të rënda që e bëjnë të detyrueshme veçimin e menjëhershëm të të burgosurit. Ndjekja e kësaj procedure do ta bënte efektive të drejtën për të ankimuar vendimin e Këshillit Disiplinor të IEVP-së, i cili mund të shfuqizohet, por ndërkohë praktikisht është shlyer nga i burgosuri. Në këtë linjë shkojnë edhe nenet e legjislacionit në fuqi, neni 63/1 i Ligjit Nr.81/2020 dhe neni 117/1 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, ku thuhet se drejtori i IEVP-së mund të urdhërojë veçimin e të burgosurit vetëm për shkelje shumë të rënda disiplinore, duke e vendosur në mjediset e veçimit, deri në mbledhjen e komisionit disiplinor.

Së fundi, sjellim në vëmendjen Tuaj se, e drejta për një proces të rregullt ligjor sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht në nenin 42/1 ku thuhet se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo është shprehur se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masë administrative, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*”

## **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për përmirësimin e procedurës që duhet të ndiqet nga administrata e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, sa i përket njohjes së të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohës (afatit) së zbatimit të saj, duke i kërkuar atij të nënshkruajë vendimin e marrë ndaj tij si në kopjen që i dorëzohet ashtu edhe në atë që ruhet në dosjen personale, dhe në rast refuzimi, vendimi të nënshkruhet nga dy persona të tjerë të personelit me shënimin “refuzon firmën”.
2. Marrjen e masave për vendosjen e plotë të bazës ligjore që ka të bëjë me shkeljen e të burgosurit, të cituar në vendimin e masës disiplinore.
3. Përgjithësimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në të gjitha IEVP-të, për të garantuar respektimin e të drejtave të personave të burgosur gjatë procedurës së dhënies ndaj tyre të masave disiplinore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**